

Vendim nr. 144 datë 05.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 05.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 31 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ASTRIT ÇEÇAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1555, datë 16.04.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-3723, datë 04.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); neni 1i Protokollit 1 të KEDNJ-së; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore ka rezultuar se kërkuesi Astrit Çeçaj ka qenë kreditor i shtetasit E.M., për shumën totale 1.240.000 USD, sipas deklaratës së nënshkruar nga shtetasi E.M. në datën 25.04.2003 dhe kontratës nr. 2567 rep., nr. 299 kol., datë 29.07.2004 të huas të lidhur mes tyre.

2. Ndërkohë, shtetasi E.M., me kontratën nr. 4386 rep., nr.1004 kol., datë 16.07.2003, i ka shitur shtetasit B.T. 1/2-n pjesë të pandarë të një trualli në bashkëpronësi të tyre, me sipërfaqe totale 50 478 m², kundrejt çmimit të shitjes 1.000.000 lekë. Kontrata e shitjes është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë (ZVRPP) dhe pronësia ka kaluar në emër të B.T.

3. Pas vdekjes së shtetasit E.M. në datën 14.12.2005, si trashëgimtarë ligjorë janë njohur fëmijët e tij F.M. dhe K.M., meqenëse më parë kishte zgjidhur martesën me bashkëshorten e tij A.H. Në datën 03.07.2005 rezulton se ka vdekur edhe shtetasi B.T., si rrjedhojë pasuria ka kaluar në emër të trashëgimtarëve të tij ligjorë, konkretisht bashkëshortes V.T. dhe fëmijëve D.T., R.T. dhe A.T., të cilët kanë përfutur secili nga 1/4-n pjesë të pasurisë trashëgimore, ku përfshihej edhe trualli me sipërfaqe 50.478 m².

4. Ish-bashkëshortja e trashëgimlënësit E.M., A.H., i është drejtuar gjykatës duke paditur trashëgimtarët e B.T. me padi me objekt kundërshtimin e kontratës së shitjes nr. 4386 rep., 1004 kol., datë 16.07.2003, me të cilën E.M. i kishte shitur B.T. 1/2-n pjesë të pandarë të truallit me sipërfaqe 50 478 m² (*shih paragrafin 2 të këtij vendimi*).

5. Mosmarrëveshja e sipërcituar është zgjidhur duke u lidhur aktmarrëveshja nr. 6752 rep., nr. 2525 kol., datë 03.10.2006, e cila është pasuar nga kontrata e dhurimit nr. 6764 rep., nr. 2535 kol., datë 04.10.2006, sipas së cilës trashëgimtarët e B.T. (bashkëshortja V.T. dhe fëmijët D.T., R.T. dhe A.T.) i kanë dhuruar A.H. një tokë truall me sipërfaqe 12.500 m² (e cila është pjesë e sipërfaqes së tokës truall prej 50 478 m²), të ndodhur në Kashar. Kjo kontratë rezulton se është regjistruar në ZVRPP-në, Tiranë.

6. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore ka rezultuar se sipërfaqen e tokës truall 12.500 m², të përfutur me kontratën e dhurimit, A.H. ua ka shitur shtetasve K.B. dhe Z.H. Ndërsa këta të fundit ia kanë shitur një shoqërie ndërtimi. Gjithashtu, me kontratën nr. 7146 rep., nr. 2695 kol., datë 02.11.2006, edhe trashëgimtarët e B.T. truallin me sipërfaqe 37 978 m² ia kanë shitur po së njëjtës shoqëri ndërtimi.

7. Për sa më lart, rezulton se e gjithë pasuria, e cila në fillim ishte në bashkëpronësi të trashëgimlënësve E.M. dhe B.T., pas tjetërsimeve të sipërpërmendura, i ka kaluar në pronësi shoqërisë së ndërtimit, e cila, më pas, ka kryer tjetërsime të tjera dhe si rrjedhojë e këtyre tjetërsimeve, në emër të saj, nga e gjithë sipërfaqja totale 50 478 m², kanë mbetur dy parcela me sipërfaqe respektive 725 m² dhe 2375 m².

8. Kërkuesi ka pretenduar se ka qenë kreditor i trashëgimlënësit E.M. për shumën 1.240.000 USD, përpara se të kryej veprimi juridik i kontratës nr. 4386 rep., nr. 1004 kol., datë 16.07.2003 për shitjen e tokës me sipërfaqe 50 478 m². Kërkuesi, gjithashtu, ka pretenduar se

çmimi i shitjes prej 1 000 000 lekësh, për 1/2-n pjesë të pandarë të kësaj toke, është disa herë më i ulët se çmimi i blerjes, pra është çmim fiktiv dhe tregon se debitori E.M. ka pasur si qëllim pakësimin e pasurisë së tij, me qëllim mosshlyerjen e detyrimeve ndaj kërkuesit. Gjithashtu, sipas kërkuesit, bashkëshortet respektive kanë qenë në dijeni për të gjitha veprimet juridike të sipërcituara dhe se ato po kryheshin me qëllim dëmtimin e atij si kreditor. Për të gjitha këto arsye ai i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi me objekt deklarimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes nr. 4386 rep., nr. 1004 kol., datë 16.07.2003 të lidhur mes E.M. dhe B.T., dhe të pavlefshmërisë të kontratës së dhurimit nr. 6764 rep., nr. 7335 kol., datë 10.04.2006 të lidhur mes ish-bashkëshortes të E.M., A.H. dhe trashëgimtarëve të B.T., si dhe detyrimin e ZRPP-së, Tiranë të bëjë çregjistrimin e efekteve të ardhura si rezultat i këtyre kontratave.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 11101, datë 16.11.2012, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj e prova.

10. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1555, datë 16.04.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 11101, datë 16.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, pasi kërkuesi kishte ngritur një padi ku ka kërkuar pavlefshmërinë e veprimit juridik, por të pashoqëruar me një kërkim konkret për rregullimin e pasojave të kësaj pavlefshmërie.

11. Ndaj vendimit ka ushtruar rekurs kërkuesi dhe në datën 25.11.2020 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

12. Në datën 03.10.2022 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendim të ndërmjetëm, ka revokuar vendimin e caktimit të çështjes në seancë gjyqësore, të planifikuar për në datën 25.11.2020, dhe e ka kthyer çështjen për shqyrtim në dhomë këshillimi mbi bazë të dokumenteve në datën 04.11.2022.

13. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (*Gjykata e Lartë*), me vendimin nr. 00-2022-3723, datë 04.11.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi shkaqet e parashtruara janë të ndryshme nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

14. Kërkuesi në datën 04.05.2023 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili është regjistruar përfundimisht në datën 18.05.2023.

II

Pretendimet e kërkuesit

15. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:

15.1. *Së drejtës së aksesit substancial*, pasi Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka bërë shqyrtim të plotë gjyqësor për të vlerësuar të gjitha rrethanat e çështjes dhe ndonëse ishte në rrethana të ndryshme nga ato që kanë diktuar marrjen e vendimit unifikues nr. 5, datë 30.10.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendim unifikues nr. 5/2012*) (i referuar në vendim) ka vendosur pushimin e çështjes, duke mos i dhënë zgjidhje çështjes në themel. Gjykata e Apelit Tiranë, pasi lejoi debatin dhe shqyrtoi provat duhet ta zgjidhte çështjen me dhënien e një vendimi përfundimtar, duke mundësuar aksesin në gjykatë. Gjykata e Apelit duhet ta kishte kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për të orientuar palët në caktimin e ndërgjyqësisë, objektin e padisë, duke përfshirë rregullimin e pasojave, si dhe për hetimin e plotë dhe të gjithanshëm, për t'i mundësuar kërkuesit mbrojtjen gjyqësore si kreditor.

15.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka bërë të qarta arsyet pse padia nuk mund të ngrihej dhe referenca në vendimin unifikues nr. 5/2012 nuk është e mjaftueshme për të mbështetur arsyetimin e vendimit. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit, me arsyetimin se rekursi nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara në ligj, ndërkohë që kërkuesi kishte ngritur pretendime për zbatimin e gabuar të ligjit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

16. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Individidi, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000 mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

17. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së

drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht.

18. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që individi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues. Në mbështetje të këtij kuadri kushtetues do të vlerësohet legjitimitimi i kërkuarit, duke analizuar me radhë kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.

19. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Kolegji vlerëson se kërkuari, si individ, legjitimohet në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

20. Një tjetër kriter paraprak, që duhet të përmbushet nga individi përpara se t’i drejtohet kësaj Gjykate, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive* në dispozicion. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuari përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

21. Qëllimi i këtij kriteri është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë (*shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ajo pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 24, datë 11.10.2022; nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin konkret vërehet se kërkuari në objektin e ankimit kushtetues individual ka kundërshtuar vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuari ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

23. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve

gjqësore, ka llogaritur afatin 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata, që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin konkret, rezulton se vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procesin gjyqësor, mban datën 04.11.2022. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për vënien të dispozicion të datës së zbardhjes së vendimit. Kancelari i Gjykatës së Lartë, me shkresën nr. 2228/1, datë 28.04.2023, ka sqaruar se vendimi është bërë i disponueshëm për palët në datën 26.01.2023 dhe është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë në datën 31.01.2023. Në këto rrethana, ankimi kushtetues individual i paraqitur në datën 04.05.2023 është brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga ligji.

25. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit substancial në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit Tiranë, si dhe nga Gjykata e Lartë. Këto pretendime *prima facie* hyjnë në kompetencën e Gjykatës, ndaj Kolegji do t'i analizojë në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit substancial

26. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka bërë shqyrtim të plotë gjyqësor për të vlerësuar të gjitha rrethanat e çështjes dhe ndonëse ishin të ndryshme nga ato që kanë diktuar marrjen e vendimit unifikues nr. 5/2012, ka vendosur pushimin e çështjes, duke mos i dhënë zgjidhje çështjes në themel. Ajo duhet ta kthente çështjen për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për të orientuar palët në caktimin e ndërgjyqësisë, objektin e padisë, duke përfshirë rregullimin e pasojave, si dhe për të kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

27. Gjykata në jurisprudencë të vazhdueshme ka theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi dhe zbatimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Ajo nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit

gjyqësor (shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 13, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

28. Në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Apelit Tiranë në mënyrë të përmbledhur ka arsyetuar se padia objekt kundërshtimi, referuar kërtimeve të saj, nuk mund të ngrihej dhe se në rastin konkret gjente zbatim vendimi unifikues nr. 5/2012, si dhe kërkitimi për çregjistrimin e veprimeve juridike nga ZRPP-ja nuk mund të konsiderohej si zgjidhje e pasojave të pavlefshmërisë absolute, bazuar në nenin 193, shkronja “h”, të Kodit Civil.

29. Për sa më lart, referuar pretendimeve të kërkuarit, Kolegji vlerëson se argumentet e tij për cenimin e së drejtës së aksesit substancial në Gjykatën e Apelit Tiranë kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, si dhe zbatimin dhe interpretimin e ligjit, dhe si të tilla nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

30. Kërkuari ka pretenduar cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, duke parashtruar dy shkaqe: (i) arsytimi i Gjykatës së Apelit Tiranë se padia nuk mund të ngrihej, nuk është i qartë dhe referenca në vendimin unifikues nr. 5/2012 nuk është e mjaftueshme për të mbështetur arsyetimin e vendimit; (ii) Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit, me arsyetimin se rekursi nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara në ligj, ndërkohë që kërkuari kishte ngritur pretendime për zbatimin e gabuar të ligjit, për të cilat Gjykata e Lartë duhet kishte dhënë përgjigje të arsyetuar.

31. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë (shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese). Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

32. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, Gjykata ka theksuar se nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Nëse kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Kjo është edhe përgjigjja që Gjykata e Lartë u jep pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimet e mospranimit të rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji konstaton se për shkakun e parë, për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Apelit Tiranë, kjo gjykatë ka arsyetuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka zhvilluar një proces në respektim të dispozitave procedurale, por, nga ana tjetër, referuar analizës së fakteve, ajo ka shqyrtuar një padi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik, të pashoqëruar me asnjë kërkim për rregullimin e pasojave të kësaj pavlefshmërie. Për këtë arsye, Gjykata e Apelit Tiranë i është referuar edhe vendimit unifikues nr. 5/2012. Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se kërkuesi nuk ka përcaktuar detyrimin e pretenduar dhe veç konstatimit të pavlefshmërisë së kontratës nuk ka kërkuar asnjë rivendosje të së drejtës së tij ose thënë ndryshe nuk ka kërkuar të rregullojë pasojat e pavlefshmërisë. Gjykata e Apelit Tiranë ka vijuar në arsyetim se pretendimi se

veprimi juridik në vitin 2003 ishte kryer për të mosshlyer detyrimet, nuk provohet. Sipas saj, kërkuesi jo vetëm nuk e ka kundërshtuar, por një vit më vonë, në vitin 2004, ka rinovuar dhe formalizuar marrëdhënien e detyrimit (*shih faqet 8-9 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*). Në përfundim, ajo ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, duke mos e zgjidhur çështjen në themel. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se në përmbajtjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nuk vërehen paqartësi, kundërrthënie dhe se ai respekton standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor.

35. Ndërsa në lidhje me shkakun e dytë, Kolegji konstaton se nga përmbajtja e vendimit nr. 00-2022-3723, datë 04.11.2022 të Gjykatës së Lartë rezulton se janë pasqyruar palët, faktet e çështjes, vendimmarrja e gjykatave më të ulëta, fakti se kërkuesi ka ushtruar rekurs, duke parashtruar shkaqet e rekursit. Gjithashtu, në vendim janë pasqyruar ndryshimet ligjore të KPC-së dhe se me vendimin e ndërmjetëm të datës 03.10.2022 është vendosur revokimi i vendimit për caktimin e seancës gjyqësore të datës 25.11.2020 dhe kthimi i çështjes për shqyrtim në dhomën e këshillimit, bazuar në nenin 485 të KPC-së, pas ndryshimeve me ligjin nr. 44/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

36. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk përmban asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga ligji. Ajo ka arsyetuar se Gjykata e Apelit Tiranë ka respektuar ligjin procedural e atë material, duke i interpretuar dhe zbatuar ata, si dhe vendimi i asaj gjykate nuk është në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë respekton standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor.

37. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuetit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe nga Gjykata e Lartë është haptazi i pabazuar.

38. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.